

Turizmi i trashëgimisë ish-komuniste, çështje të identitetit kulturor dhe kombëtar dhe nevoja e promovimit të spikatur të nocioneve universale të përkujtimit të 23 Gushtit si “Dita e Ndërgjegjes Europiane dhe Viktimave të Totalitarizmit”, rasti i kampit në Tepelenë

Nga Hektor Çiftja, universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan

Kumtesë e mbajtur në simpoziumin "Tepelena në dy kohë", 23 gusht 2023

Në vend të hyrjes

Punimi “Turizmi i trashëgimisë ish-komuniste, çështje të identitetit kulturor dhe kombëtar dhe nevoja e promovimit të spikatur të nocioneve universale të përkujtimit të 23 Gushtit” (si Dita e Ndërgjegjes Europiane dhe Viktimave të Totalitarizmit-rasti i kampit në Tepelenë) është pjesë e një punimi kërkimor në vazhdim.

Në punimin në tërësi, trajtohet rasti i Shqipërisë duke marrë shembull studimi Kampin e Tepelenës si një rast që ilustron disa teza shkencore të një literature kërkimore perëndimore që fillon në vitet ‘90 në frymën e një kërkimi shkencor konceptual. Përveç një bibliografie shteruese teorike, studimi i ardhshëm pritet të marrë në shqyrtim dhe të trajtojë të dhëna gjithëpërfshirëse të mbledhura në mënyrë empirike në muzetë apo site-t muzeale të trashëgimisë komuniste në Shqipëri.

Synimi i parë i punimit është ta bëjë rastin e Shqipërisë pjesë të literaturës bashkëkohore studimore. Synimi i dytë dhe më kryesor i punimit është të hedhë për diskutim tezën nëse site-et kulturore-turistike të trashëgimisë së ish-komunizmit dhe fashizmit duhet të ndërtohen në një formë të tillë ku të spikasin më qartë dhe të dominojnë mesazhet universale që dalin, Deklarata e Pragës 2008, nga rezolutat e Parlamentit Europian (2009), Deklarata e Vilniusit (OSBE) si “krimet kundër njerëzimit”, “krimet e luftës”, “Genocidi”, “Dhunimi i të drejtave dhe lirive të njeriut”, “dënimi i glorifikimit të regjimeve totalitare” e shumë mesazhe të tjera si këto, krahasuar me situatën e sotme ku kemi një paraqitje “të ngrirë” për të kënaqur kureshtjen e një kategorie turistësh kureshtarë të interesuar për vendet e ish-Lindjes komuniste dhe për një “arkeologji nazi-fashiste dhe ish-komuniste”.

Në kontekstin e “turizmit në vendet e trashëgimisë nazifashiste dhe ish-komuniste” dhe sidomos në kontekstin e debatit mbi identitetin që ka sjellë promovimi i këtyre site-ve të trashëgimisë, është e mundshme dhe e domosdoshme që duke nënvizuar mesazhet universale të 23 Gushtit në këto site, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të hapur, jo vetëm të marrë formë **mbi**-partizane debati ideologjik dhe identitar, por sidomos të transmetohet mesazhi universal i parapërgatitjes për parandalimin e fenomeneve të tilla. Në fund të fundit, ky është thelbi i

“ndërgjegjes europiane” dhe ky duhet të jetë synimi i vendeve si Shqipëria kur promovojnë sajte të kësaj trashëgimie të dënuar nga historia.

Atraksioni turistik i komunizmit

Nëse shumë dekada më parë perëndimorët udhëtonin drejt shteteve komuniste duke kërkuar të shihnin si dëshmitarë okularë krijimin e një regjimi të ri premtues, tashmë ekziston një treg në rritje i industrisë së turizmit që përbëhet nga perëndimorët që dëshirojnë të shohin gjëmadhat-artefakte të së njëjtës botë, por tashmë të dështuar.

Deri në mesin e shekullit XX, një e treta e planetit i bindej rregullave të drapër e çekanit si simbol i miteve të kohës të aleancës së fshatarësisë me të ashtuquajturën klasë punëtore dhe që në variantin shqiptar ishte kazma dhe pushka që bënte dhe bën edhe sot konfuz se çfarë simbolizonte. Sot Shqipëria ka braktisur zyrtarisht të qenët e udhëhequr nga një ideologji e dështuar dhe me pasoja kriminale, dhe ideologjia e vetme udhëheqëse duket se është të afrohet sa më shumë në praktikë me vlerat e humanizmit europian, me një klasë politike që legjitimohet nga ideja e rikthimit të Shqipërisë drejt perëndimit si vlerë dhe si orientim i mbështetur pa diskutim nga shumica e shqiptarëve dhe me një flamur kombëtar pa asnjë nga shenjat e ish-Lindjes, por që reflekton një ideologji pozitiviste kombëtariste, dhe gjithashtu, në heraldikën dhe veksilologjinë (eng: vexilology) që është shkencë e historisë, simbolikës dhe përdorimit të flamujve, i bashkohet tërësisë së simboleve kombëtare që reflektojnë pikërisht vlerat europiane.

Për më tepër, vdekja e epokës komuniste dhe staliniste, në mënyrë të papritur ka bërë atraktive mundësi të panjohura më parë në tendencat e industrisë së turizmit: nga turisti që dëshiron të shikojë transformimin e vendeve, si Kuba në vende të resorteve turistike, deri tek turisti perëndimor i cili ka thjesht një kuriozitet për një tjetër qytetërim (në kuptimin që historianët i japin kësaj fjalë, qytetërim pra tashmë të zhdukur; degradimin i komunizmit dhe stalinizmit shqiptar si një forcë ideologjike e ka zhvendosur atë nga sfera e politikës dhe e ka ripozicionuar në sferën e turizmit. Stalinizmi shqiptar, i cili nuk përbën më një sfidë apo terror, ai mund të përbëjë tani një komponent kyç të tregut që u përmend më lart, një treg në të cilin gjëmadhat dhe relikte mund të vëzhgohen nga njerëz të çliruar nga ndonjë ndikim politik, siç ndodh me atraksionin që ngjallin qytetërimet e tjera të shkatërruara

Në përfundim, edhe pse çdo lloj i turizmit në site-et ish-komuniste ka një dinamikë unike, gjithçka lidhet me një përpjekje që secili të përjetojë gjëmadhat e këtij qytetërimi të dështuar në mënyrën e tij. Kjo shoqëri e vendeve ish-komuniste e cila me një shpejtësi marramendëse

mposhti një të tretën e botës, ndaloi së funksionuari në mënyrë pothuajse të menjëhershme dhe u çmontua pothuajse tërësisht brenda disa dekadash. Komunizmi ishte unik në shekullin e 20-të, apo të paktën në epokën e modernitetit në kuptimin që përfaqësonte një përpjekje për të përmbysur të kaluarën mijërvjeçare në mënyrë të vetëdijshme gjithëpërfshirëse dhe të zëvendësonte gjithçka me një qytetërim të ri.

Brenda një gjenerate të vetme, e gjithë kjo sipërmarrje u diskreditua dhe vetë udhëheqësit e saj hoqën dorë nga ajo. Është për këtë arsye, që kjo sipërmarrje ideologjike dhe politike mund të klasifikohet në kuptimin arkeologjik si qytetërim, edhe pse nuk zgjati më shumë sesa një jetë njerëzore. Përpjekjet e komunizmit për të zhdukur tërësisht të kaluarën shekullore, për ta betonuar atë dhe mbi atë beton të krijonin një shoqëri të re, është një nga arsyet se pse kjo politikë dikur agresive jo vetëm dështoi, por edhe u fishk, u bë thjesht një kapitull i historisë botërore, ashtu si edhe inkuizicioni apo djegia e Romës nga perandori i saj dhe tashmë po zëvendësohet nga një kuriozitet i mirëfilltë. Edhe kur ky kuriozitet mund të jetë ndaj ndërtesave imponante prej betoni të ish-blokut komunist, apo ndjesitë e ngrira në kohë në Havana të Kubës. Kurioziteti eksplorues deri në lodhje që vjen duke parë frymën e fundit të një sistemi që jetoi më gjatë sesa arsyeja njerëzore, është një kuriozitet që e kemi parë në të gjitha kohërat: ashtu si udhëtarët e shekullit të XIX mahniteshin nga statujat e ngritura nga romakët, turistët e sotëm kënaqen duke pyetur veten me habi, edhe pse me aspak nderim, kur janë pranë gërmadhave të lëna nga përpjekjet e komunizmit për të krijuar një botë të re.

Duke i mëshuar deri tani aspektit turistik të site-ve të trashëgimisë totalitare, duket se po japim përshtypjen e murgut të zhytur në libra e të shkëputur nga realitetit jo dhe aq i largët dhe që i duket ky fenomen historik si një rrëzim statujash ideologjike dhe mahnitje nga gërmadhat. E vërteta është që, midis shumë funksioneve, turizmi është një platformë ku produktet kulturore të thonë shumë më tepër sesa një ideologji e falimentuar. Këto produkte kulturore të këtij civilizimi, nuk mundet të mos të të orientojnë drejt makabritetit, dhunimit në mënyrë masive të dinjitetit njerëzor, krimeve masive që nuk ishin vetëm në emër të ideologjisë, por edhe sikur të ishin vetëm për hir të saj, e theksoj, edhe sikur të ishin vetëm për hir të saj, janë krime kundër njerëzimit ndaj të cilave humaniteti ka një qëndrim mendor dhe shpirtëror dënues dhe të ashpër, ato nuk mundet të mos ta bëjnë edhe turistin më të paineduar të rikujtojë se çfarë është dhuna njerëzore e ushtruar nga aparatet shtetërore, e toleruar nga ata. Sado e veshur me zbukurime ideologjike, fetare, apo të çdo lloji, gjenocidi, tortura, vrasja, edhe kur është masive, ajo duhet parandaluar. Nuk është e rastit, që edhe pse projekte si ai i Muzeut të Kampit të Tepelenës janë

ndërtuar në kuadër të programeve madhore për turizmin, ato mbajnë emra shumë domethënës si “rrugët e kujtesës”,ⁱ dhe kujtesa nuk specifikohet, sepse gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, institucionit i torturës, vrasjet masive dhe dënimet me vdekje, dhe në të gjitha rastet pa gjyq në kuptimin e mirëfilltë të fjalës kanë manifestimin më makabër në rastin e regjimeve fashiste apo të Lindjes ish-komuniste, por ato duhen kujtuar për të qenë të vetëdijshëm për të parandaluar që në themel ato krime, sidomos ato të specifikuara në Rezolutën Europiane të 23 Gushtit 2009. Nuk është e rastit që shumë sajte online (eng: Online sites) që i janë përkushtuar turizmit, dhe sidomos atij në Shqipëri, ato quhen “Site-t e turizmit të errësirës” (Dark Tourism Sites). Në njërin prej tyre madje gjejmë edhe paralajmërimin për turistët:

“Many communist sites in Albania are dark tourism sites where cruel and horrifying things have happened. Things you will see and learn about will often be disturbing and unsettling. Prepare both mentally and intellectually before you visit them. Think twice about why you are visiting the place. Is it just curiosity, or do you actually want to understand what happened there?” ⁱⁱⁱ që në gjuhën tonë do të thotë: “Shumë site komuniste në Shqipëri janë “dark tourism sites”, në të cilat kanë ndodhur gjëra mizore dhe tmerruese. Gjërat që do të shikoni dhe për të cilat do të mësoni do të jenë shpesh shqetësuese dhe trazuese. Përgatituni edhe mendërisht edhe intelektualisht përpara sesa t’i vizitoni ato”.

Muzeologjia dhe arkivistika

Ekziston një literaturë e tërë studimore që dëshmon se që në fillimin e këtyre projekteve, fillimisht në Gjermani në raport me nazizmin e më pas më site-t e trashëgimisë komuniste është zhvilluar një debat publik, kryesisht në media për dy aspekte themelore: njëri nga debatet është përqendruar në frikën e imagjinuar se duke i bërë këto vende destinacione turistike, në tregun e industrisë së turizmit mund të krijohet përshtypja e gabuar e identifikimit të këtyre krimeve me natyrën e një kombi të tërë, që më së shumti është formuluar si debati “turizmi dhe identiteti i një vendi”. Debati i dytë është përqendruar në frikën mediatike se mos nga ana e turistëve, artefaktet e site-ve ish-komuniste dhe ish-naziste e paraqesin të vërtetën në kuptimin që i jep shkenca e historisë, apo e nxjerrin nga konteksti historik për ta bërë të marketueshme për tregun e industrisë së turizmit duke deformuar kështu perceptimin e të vërtetës. Temat duket se kanë qenë kontroverse dhe në të gjitha vendet që ka pasur projekte të tilla, ka pasur gjithashtu debate të ngjashme po aq të nxehta. Në të dyja rastet, debatet kanë ndjekur narrativa që ne i kemi përmbledhur në paradigmat e mëposhtme. Gjithsesi, studiuesit kanë arritur në përfundimin se këto debate nuk kanë ndikuar në zhvillimin e projekteve, por kanë ndihmuar që të bëhen edhe

një herë të qarta për publikun e gjerë koncepte themelore, siç është jo vetëm dallimi midis muzeologjisë dhe arkivistikës, por edhe konceptin që turizmi, si një nga platformat e shfaqjes së përmbajtjes kulturore, për shkak të natyrës së tij të pacentralizuar, nuk është për t'u pasur frikë si ndikim në krijimin e një përfytyrimi për identitetin e një vendi, pasi produkti kulturor në tregun turistik, me përkufizim, është i gjithanshëm dhe gjithëpërfshirës.

Rast studimor: Muzeu i Kampit të Tepelenës

Siç u përmend edhe më lart, edhe lajmi për projektin e muzealizimit të Kampit të Tepelenës nuk kaloi pa debate mediatike, të cilat rastësisht përkuan në vija të përgjithshme me paradigmat e debatit të zhvilluar në vende të tjera me histori të ngjashme.

Paradigma e parë dhe narrativa e parë

Muzeologjia duhet t'i përmbahet një narrative historike të caktuar që besohet nga një palë e diskutimit: *Narrativa: Ishte një kamp që duhet parë në kontekstin e kohës, funksiononte për ata që kishin të arratisur në ish-Jugosllavi, dhe familjet duhet të ishin sa më larg të arratisurve sepse të arratisurit po përgatiteshin të ndërhynin ushtarakisht; të arratisurit ishin projugosllavë dhe nacionalizmi i diktaturës donte të mbronte kombin si territor: Raporti i CIAS është hartuar mbështetur nga burime jugosllave, dëshmitë gojore të të mbijetuarve nuk përbëjnë dokument. Për mbi të gjitha, hierarkia e lartë e shtetit nuk dinte gjë për këtë që ndodhte, madje kur e kish marrë vesh udhëheqësi, del një dokument që urdhëron të shtohet edhe një racion supe në ditë (sa i mirë udhëheqësi!!! (shënim.)*

Kjo narrativë shtron përpara një mendjeje analitike dhe kritike konstatime të tilla: edhe nëse do të ishte kështu, edhe pse argumenti nisët nga premisa bindjesh politike (“diktatura e mirë, por ne nuk e kuptojmë”) dhe jo nga premisa historike dhe as humanitare, një fenomen i tillë duhet të mbajë dy emrat që ka dhe këto emra janë: “gjenocid” dhe “krim kundër njerëzimit”.

Paradigma e dytë dhe narrativa e dytë

Të internuarit ishin nacionalistë dhe u dënuan si të tillë, duke shkuar në ekstrem në vrasjen, apo keqtrajtimin çnjerëzor të grave dhe fëmijëve të shumtë dhe të pafajshëm. Ata janë të dënuar pa gjyq dhe ndaj tyre është ushtruar, pa asnjë ligj, por me urdhra të dokumentuar, institucioni i torturës, i dhunës, përdhunimit masiv pa diskriminim.

Edhe pse kjo narrativë, sado e saktë, është e papranueshme për palën tjetër, pikërisht sepse vendos në qendër sistemin diktatorial, për dëmet dhe krimet e të cilit një pjesë të indoktrinarish dhe nostalgjikësh nuk bien dakord. Edhe këtu kemi vendosjen e bindjeve mbi faktet dhe dëshmitë historike, dhe sido që të jetë, kjo përsëri ka vetëm një emër: krim kundër njerëzimit dhe gjenocid, sepse nga çdo aspekt apo këndvështrim, qoftë ai i mbrojtjes kombëtare, qoftë ai

i luftës së klasave, qoftë ai i luftës ndaj nacionalistëve, këtu kemi krime të pastra ndaj civilëve, dhe krimet ndaj civilëve janë të dënueshme edhe në çdo situatë lufte reale, siç janë dënimet pa gjyq apo me gjyqe formale, siç është edhe vetë dënimi me vdekje, siç është edhe vetë dënimi për bindjet apo mendimin e lirë.

Të dyja paradigmat, për shkak të diskutimit në platformat mediatike *mainstream* na çojnë tek shtrimi i pyetjes studimore mbi konceptin e identitetit. Thënë ndryshe, i ekspozuar një fenomen i tillë në muze apo në arkiva të hapura a mos vallë një prezantim i këtyre artefakteve na kthehet për turistët një instrument perceptimi për të na identifikuar si komb apo si popullsi vëllavrasëse? (në një narrativë tjetër kemi edhe “të mos i hapim këto gjëra se kush e di se çdo të dalë”, apo “të gjithë bashkëvuajtës dhe të gjithë bashkëfajtorë”, apo “ashtu e kishte sistemi”). Duke i futur në projekte të turizmit edhe paraqitje muzeale të tilla, dhe duke i parë muzetë si platforma të produkteve kulturore, ekziston një rrezik i asociimit apo i identifikimit nga ana e klientit turist të krimin dhe barbarisë nazifashiste dhe ish-komuniste me popullsinë apo kombin shqiptar i cili ka një emër të nderuar dhe të merituar në shumë epoka historike në botë.

Ndryshe nga vende të tjera komuniste (turizmi i kuq) apo ish-komuniste, në të cilat ka edhe të tilla që jetesën në vendet e ish-Lindjes, perëndimorët e kanë quajtur një “tjetër qytetërim”, edhe pse i ezauruar, por termi “qytetërim” e bën atraktiv për turistët, shqiptarët e kanë zgjidhur këtë mëdyshje duke bërë distancimin kohor. Pikërisht në traditën e historianëve bashkëkohorë perëndimorë ka kohë që në studime nuk flitet me "ne", por me "ata", njerëzit e asaj kohe (po kështu edhe në paraqitjet muzeale në Shqipëri). Sepse njerëzimi, *humanita*, nuk mund të identifikohet me manifestime të caktuara. Ky distancim shkencërisht korrekt, edhe pse vjen natyrshëm, është koncept i rëndësishëm i të shkruarit të historisë dhe i ekspozimit publik të të vërtetave të saj.

Duke lënë mënjane turizmin e jashtëm dhe duke marrë në konsideratë turizmin e brendshëm, që, jam i sigurt, është shumë i bollshëm, në rastin shqiptar, është provuar se vendet e kujtesës nuk janë burime frymëzimi për hakmarrje dhe çoroditje sociale, por vende - ku ashtu si Aristoteli konsideron zhanrin e tragjedisë dhe preferencën ndaj tij prej spektatorëve të lashtë si nevojë për një katarsis që kalon nëpërmjet riimagjimit të dhimbjes - hipoteza jonë është që një funksion të tillë e luajnë edhe këto vende të kujtesës.

Turizmi si instrument edukativ

Edhe pse studiues të ndryshëm kanë pikëpamje të ndryshme edhe ndonjëherë të kundërta për funksionin edukativ të turizmit, në rastin e projektit të Kampit të Tepelenës, ndoshta teoricienët mund të relativizojnë aspektin edukativ të turizmit, por nuk mund të relativizohet

aspekti edukativ i paraqitjeve muzeale, edhe pse një koncept i tillë nuk bën pjesë në konceptin konservator të formalizuar të edukimit. Muzetë nuk të edukojnë, si synim në vetvete, por të provokojnë mendimin dhe, në rastin më të mirë, të nxisin për të studiuar dhe për të kuptuar. Një tjetër tezë që jam duke punuar ka të bëjë me faktin se muzetë e konceptit “vendet e kujtesës” nuk duhet vetëm të na çojnë tek e shkuara, duke qenë të ndërlidhura me turizmin, ato duhet t’i kenë më të spikatura mesazhet universale mbi fenomene që njerëzimi refuzon që të përsëriten.

Kështu, në këtë vepër të jashtëzakonshme siç është Muzeu i Kampit të Tepelenës unë do të doja të shiheshin më shkoqur, me qartë, më të drejtpërdrejta fjalët: gjenocid, krim kundër njerëzimit, torturë si instrument dhune, dhunë si instrument homofobie e shumë koncepte të tjera që janë të qarta në Rezolutën e Parlamentit Europian në prill 2009 “mbi ndërgjegjen europiane dhe totalitarizmin”. Autori i këtyre radhëve, me shumë respekt dhe nderim ndaj arkitektëve dhe ideatorëve të muzeut, sugjeron që pranë objekteve të muzeut jo vetëm të shënohen të dhënat historike, por edhe të shprehen qartazi termat “krime kundër njerëzimit”, “dhunim masiv i të drejtave të njeriut”, por edhe koncepte si “e shkuara për të ardhmen”, e cila mund të jetë lajtmotiv i stendave dhe objekteve.

Gjithashtu një tjetër lajtmotiv mund të shprehet qartë: “Deportimet masive, vrasjet, skllavërimet e kryera në kontekstin e akteve të agresionit nga regjimet staliniste dhe nazifashiste kategorizohen si krime lufte dhe si krime kundër njerëzimit.”ⁱⁱⁱ Po ashtu sugjerohet të vendosen edhe fraza e deklarata për shtyp e Parlamentit Europian e dhënë mbi këtë rezolutë në 20 gusht 2021 e cila, në një përkthim të lirshëm thotë midis të tjerash: *“Le të punojmë së bashku, në mënyrë që e kaluara e përbashkët të na bëjë më të fortë drejt një të ardhmeje të përbashkët dhe të mos na largojë nga njëri-tjetri. Liria nga totalitarizmi dhe autoritarizmi nuk është e dhënë një herë e përgjithmonë. Ajo është nga ato gjëra të rëndësishme të cilat ne publikisht duhet ti dënojmë dhe të përballemi çdo ditë në mbrojtje të saj. Ajo qëndron në thelbin e idealit europian. Së bashku me sundimin e ligjit dhe demokracisë, kjo liri është bazamenti i të gjitha traktateve europiane që ne kemi nënshkruar. Ne duhet të vazhdojmë të luftojmë, të bashkuar, për këto vlera evropiane”*^{iv}.

Turisti i brendshëm dhe tregu i turizmit të huaj që vjen në Shqipëri do ta kishte më të lehtë, nëpërmjet nënvizimit të këtyre ideve, që jo vetëm të zgjeronte përvojën turistike, por edhe të largohej me mesazhe që edhe pse janë pjesë e pandarë e edukimit perëndimor, duke i rritur vetëdijen, ndihmon edhe më shumë në parandalimin e së keqes.

Në vend të mbylljes

Duke shkruar këto radhë, autori i këtij punimi pati mëdyshjen e zakonshme të atyre që merren me shkrime: çfarë i shton punimi im të kuptuarit të Muzeut të Kampit të Tepelenës? Autori ka punuar shumë për këtë material, dhe këtu kemi vetëm disa shënime, pasi kjo do të jetë një vepër në vazhdim, por, thellë-thellë, autori ndjen se ky material nuk shton asgjë më shumë sesa ajo që një i mbijetuar thotë: *“Gjella zihej nëpër kazanë që më parë kishin qenë kazanë benzine për ushtrinë italiane...edhe pse ishin përdorur për një kohë të gjatë për gatim, nxirrnin vazhdimisht një sterrë të zezë, një tip lëngu të errët...atë ushqim e hante vetëm uria.”*

E parë si metaforë, ky ushqim i dy epokave të errëta që e hante vetëm uria, e volli urrejtja për çdo krim ndaj njerëzimit, një urrejtje që nga një gjeneratë në tjetrën, duhet të kalojë në procesin e njohjes, neveritjes, vetëdijesimit dhe në transmetimin e brezave që vijnë dhe të turistëve të painformuar; se regjimet që ngrihen mbi ideologjinë e dhunës dhe presionit si mënyrë funksionimi, qoftë e formalizuar me legjislacione apo jo, i ushqejnë njerëzit nga i njëjti *kazan* që nxjerr vazhdimisht *sterrë të zezë*.

Faleminderit!

ⁱ Në projektin e hartuar nga Autoriteti për informim mbi dokumentet e ish-sigurimit të shtetit përmenden termat: “dinjiteti i njeriut është i paprekshëm”, “kampi ka karakter përfaqësues”. Në programi i qeverisjes 2017-2021 “rrugët e kujtesës që do të nxjerrë në pah aspektin historik dhe edukativ të siteve të diktaturës. “Rrugët e kujtesës është itinerar unik i Shqipërisë”.

ⁱⁱ <https://wobblyride.com/2022/11/16/communist-sites-in-albania/> nxjerrë datë 21/08/ 2023

ⁱⁱⁱ *"The mass deportations, murders and enslavements committed in the context of the acts of aggression by Stalinism and Nazism fall into the category of war crimes and crimes against humanity. Under international law, statutory limitations do not apply to war crimes and crimes against humanity."*^[3]

^{iv} *Let us work together so that our shared past makes us stronger for the shared future – and does not drive us apart. Freedom from totalitarianism and authoritarianism is not a given. It is something we need to stand up for every day anew. It is at the heart of the European ideal. Together with the rule of law and democracy, this freedom is at the core of the European Treaties we have all signed. We must continue to stand, united, for these fundamental European values.” (Europe-wide Day of Remembrance for the victims of all totalitarian and authoritarian regimes: Statement by Vice-President Jourová and Commissioner Reynders Brussels, 20 August 2021).*